



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE

Zv.KM.

V E N D I M

Nr. 773, datë 15.12.2021

P Ë R

NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.645, DATË 3.8.2020,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR PËRDORIMIN E FONDIT
TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT TË NJËSIVE
TË BANIMIT NË NDËRTESA (PALLAT) DHE NDËRTESAVE
PUBLIKE, NË ZONAT E REJA PËR ZHVILLIM, NË NJËSITË
ADMINISTRATIVE 4 E 8, ZONA "5 MAJI", DHE NJËSINË
ADMINISTRATIVE 6, ZONA "KOMBINAT", BASHKIA TIRANË",
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja "b", nënndarja "i", 16, pika 3, dhe 36, pika 1, shkronja "a", të aktit normativ nr.9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr.137/2020, "Për buxhetin e vitit 2021", të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Në pikën 2.1, të vendimin nr.645, datë 3.8.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shifra "... 990 233 627 (nëntëqind e nëntëdhjetë milionë e dyqind e tridhjetë e tre mijë e gjashtëqind e njëzet e shtatë) lekë" zëvendësohet me shifrën "... 1 490 233 627 (një miliard e katërqind e nëntëdhjetë milionë e dyqind e tridhjetë e tre mijë e gjashtëqind e njëzet e shtatë) lekë pa TVSH ...".
2. Efektet financiare përballohen nga shpenzimet buxhetore të fondit të rindërtimit, miratuar në buxhetin e vitit 2021.

3. Ngarkohen Zëvendëskryeministri dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në "Fletoren zyrtare".

K R Y E M I N I S T R I

EDI RAMA

Në mungesë dhe me porosi

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

ARBEN AHMETAJ

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI
DHE MINISTËR I SHTETIT PËR RINDËRTIMIN
DHE PROGRAMIN E REFORMAVE**

ARBEN AHMETAJ

NR.PROT. 6201/3
DATE 16.12.2021

ZËVENDËSKRYEMINISTRIT DHE MINISTËR I
SHTETIT PËR RINDËRTIMIN DHE PROGRAMIN E
REFOMAVE
MINISTRISË SË FINANCAVE DHE EKONOMISË
BASHKSË TIRANË
QENDRËS SË BOTIMEVE ZYRTARE

Sekretari i Përgjithshëm

Engjell AGAÇI

A circular official stamp of the Ministry of Economy and Finance of the Republic of Albania is visible. The stamp contains the text "REPUBLIKË E SHqipërisë" and "MINISTRI I FINANCAVE DHE EKONOMISË". Overlaid on the stamp is a handwritten signature in black ink, which appears to be "Engjell Agaçi".